



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
KOMISIONI I KONKURENCËS**

Nr. prot

Tiranë, më 14.10.2009

V E N D I M

Nr. 126 Datë 08.10.2009

“Për

mbylljen e hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve që operojnë në tregun e importit të grurit, prodhimit dhe shitjes së miellit për prodhimin e bukës dhe rekomandimet përkatëse”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e :

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Z. Koço Broka Anëtar
- Znj. Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 08.10.2009, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: a) Mbyllja e hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit prodhimit dhe shitjes së miellit për prodhimin e bukës.
b) Rekomandimet që duhet t'i drejtohen organeve përkatëse për çështje që janë evidentuar gjatë këtij hetimi

Bazë ligjore: Ligji nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” neni 24, shkronja “d”; “f”, si dhe neni 70 pika 2
Ligji Nr. 8485 datë 11. 11. 1999 “Kodi i procedurave administrative”,

Autoriteti i Konkurrencës në ushtrim të funksioneve të tij ligjore, iniciuar dhe nga shqetësimi i bërë prezent nga prodhuesit e bukës, si dhe shqetësimi mediatik lidhur me rritjen e çmimit të bukës në fillimet e vitit 2008, mori në konsideratë dhe vlerësoi nivelin e konkurrencës në tregjet e prekura.

Komisioni i Konkurrencës së Autoritetit të Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Raportit të grupit të punës për hetimin e thelluar në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit, të hapur me Vendimin Nr. 88 datë 02.10.2008 të Komisionit të Konkurrencës;

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm
- Pretendimeve të “Atlas” Sh.a dhe “Bloja” Sh.a në seancën dëgjimore të datës 27.07.2009, si dhe ato me shkrim të dërguara pranë Autoritetit të Konkurrencës, përkatësisht me Nr. 287/1 datë 21. 07. 2009, 287/2 datë 21. 07.2009, 321 prot datë 13. 08. 2009, dhe 323 prot datë 14. 08. 2009

V Ë R E N S E:

I. PROCEDURA

1. Procedura e ndjekur gjatë hetimit është bazuar në Kreun II dhe III të pjesës II të Ligjit Nr. 9121, datë 8.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (ketu e me poshte “Ligji”) dhe Ligjit Nr. 8485, datë 11.11.1999 “Kodi i procedurave administrative”.
2. Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, germa “d” dhe nenit 43, pika 1 të ‘Ligjit’ si dhe nenit 21, pika 4, te Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit te Konkurrencës”, me Vendimet Nr. 88 datë 02.10.2008 Nr. 101 datë 05.02.2009 vendosi: “Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit si dhe në tregun e prodhimit dhe shitjes së miellit për prodhimin e bukës”.
3. Në përfundim të procedurave hetimore, Sekretariati ka paraqitur raportin përkatës pranë Komisionit të Konkurrencës.
4. Komisioni i Konkurrencës nga shqyrtimi i këtij raporti, konstatoi ekzistencën e nje marrëveshjeje të ndaluar në tregun e importit të grurit dhe prodhimit e shitjes se miellit midis ndërmarrjeve “Atlas” Sh.a dhe “ Bloja” Sh.a dhe me Vendimin Nr. 113 datë 19.05.2009, ka vendosur ndalimin e kësaj marrëveshjeje në zbatim të ‘Ligjit’.
5. Ky vendim si dhe raporti i hetimit të thelluar iu komunikua ndërmarrjeve “Atlas” Sh.a dhe “Bloja” Sh.a me anë të shkresës Nr. 228 datë 25.05.2009 të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës.
6. Në zbatim të nenit 39 të ‘Ligjit’ palët nën hetim paraqitën pretendimet e tyre mbi raportin e hetimit të thelluar në seancën dëgjimore si dhe me shkrim¹, të cilat janë marrë në konsideratë nga Komisioni i Konkurrencës.

II. PERIUDHA E HETIMIT DHE NDËRMARRJET NËN HETIM

7. Periudha e hetimit, e përcaktuar nga Komisioni i Konkurrencës në Vendimin Nr.88 datë 02.10.2008 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit”, është 01 Janar 2005 -31 Gusht 2008.
8. Ndërmarrjet nën hetim janë përcaktuar në Vendimet Nr. 88 datë 02. 10. 2008 dhe 101 datë 05. 02. 2009 të Komisionit të Konkurrencës janë:

¹ Përkatësisht shkresat 287/1 datë 21. 07. 2009, 287/2 datë 21. 07.2009, 321 prot datë 13. 08. 2009, dhe 323 prot datë 14. 08. 2009

a) Ndërmarrje importuese të grurit për bukë:

- Ndërmarrja “Alagro” Shpk, me seli në adresën: Bul “Zogu I” Tirana Biznes Center.
- Ndërmarrja “Alcor – Grain” Shpk, me seli në adresën: Lagjja nr.4, Rruga Skënderbej, Kati IV.
- Ndërmarrja “GLAN” Shpk, me seli në adresën: Xhafzotaj, Godinë -1 Katëshe, Përballë ish-Metalikes, Shijak, Durrës.
- Ndërmarrja “I.A.M” Shpk, me seli në adresën: Xhafzotaj, Shijak, Durrës.
- Ndërmarrja “Shabani” Shpk, me seli në adresën: Portëz, Fier.

b) Ndërmarrjet importuese të grurit dhe prodhuese të miellit:

- Ndërmarrja “Alb Mines Investment” Shpk, me seli në Muçaj, Vorë.
- Ndërmarrja “Atlas” Sha, me seli në adresën: Rruga nacionale Tiranë – Durrës, Yrshek, Kashar.
- Ndërmarrja “Bloja” Sha, me seli në adresën: Rruga e Kavajës, Tiranë.
- Ndërmarrja “Italy Agrofood” Shpk, me seli në adresën: Rr: “K. Muco”, nr.25, Fier.
- Ndërmarrja “Mielli” Sha me seli në adresën: Rruga e Kavajës, pranë Kombinatit Ushqimor, Tiranë.
- Ndërmarrja “Vllaznimi B” Shpk, me seli në adresën: Lagjja nr.2, Kavajë.

c) Ndërmarrje vetëm prodhuese të miellit.

- Ndërmarrja “Abduramani” Shpk, me seli në fshatin Topojë, Fier.
- Ndërmarrja “Euromill Erina” Shpk, me seli në adresën: ish N.P.A Elbasan.
- Ndërmarrja “ONIR” Shpk, me seli në adresën: Lagjja.”Luigj Gurakuqi”, Nr 16 Elbasan.
- Ndërmarrja “Skraqi” Shpk, me seli në adresën: Lagjja”Dyli Haxhire”, Elbasan.

III. STRUKTURA E TREGUT

9. Tregu përkatës, në bazë të nenit 3 pikës 7 të ‘Ligjit’ dhe te Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 76 datë 07. 04. 2008 “Për miratimin e udhëzimit për përcaktimin e tregut përkatës” përcaktohet në dy dimensione:

- a. Tregu i produkteve
- b. Tregu gjeografik

III.1 Tregu përkatës i produkteve

10. Bazuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 88, datë 02.10.2008 “Mbi hapjen e hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit”, tregu përkatës i produktit përfshin:

- Tregun e importit të grurit për prodhimin e miellit²
- Tregun e prodhimit dhe të shitjes së miellit për bukë

Tregu gjeografik i referohet territorit të Republikës së Shqipërisë.

Struktura e tregut të importit të grurit

Tregu i importit të grurit paraqet karakteristikat e një tregu shumë të përqendruar³.

11. Pesë ndërmarrjet kryesore në tregun e importit të grurit janë “Bloja”SHA, “Atlas”SHA, “Shoqëria Anonime Miell” Sha, “IAM” Shpk dhe “Glan”Shpk. Pjesa e tregut⁴ që zënë këto ndërmarrja (CR5) në vitet 2005-2008 është përkatësisht 95.66%, 95.37% 82.08% dhe 85.35%.⁵

Nëntregu i shitjes së grurit për bukë.

12. Gjate viteve 2005-2006 tregu i shitjes së grurit ka qenë shumë i përqendruar⁶. Nga analiza e pjesëve të tregut rezulton se për vitet 2005-2006, pesë konkurrentët kryesorë “Bloja” Sha, “Alagro” Shpk, “Shoqëria Anonime Mielli” Sha, “IAM” Shpk dhe “Vllaznimi B” Shpk, zotërojnë 100% të tregut

13. Në vitin 2007 , konkurrentët kryesorë janë ndërmarrjet “Bloja” Sha, “IAM” Shpk, “Shoqëria Anonime Mielli” Sha, “ALAGRO” Shpk dhe “Vllaznimi B” Shpk që zënë 90% të tregut dhe në 8 mujorin e vitit 2008 CR5 është 78% ku ndërmarrjet e përfshira janë “Bloja” Sha, “Atlas” Sha, “Shoqëria Anonime Mielli” Sha, “IAM” Shpk dhe “GLAN” Shpk.

Tregu i prodhimit dhe i shitjes të miellit për bukë

14. Nga analiza e pjesëve të tregut për vitet 2005-2006-2007 vihet re se pjesa e tregut e 3 ndërmarrjeve kryesore në treg (CR3), është relativisht shumë e lartë⁷

² Në analizën e tregut të importit të grurit, nuk është përfshirë sasia e importit të grurit për mbjellje dhe ajo e importit të grurit “durum”, i cili përdoret për prodhimin e makaronave

³ Indeksi i përqendrimit për vitin 2005 është 2191; për vitin 2006 është 2351, për vitin 2007 është 1545 dhe për 8 mujorin e vitit 2008 ky indeks është 1805

⁴ Llogaritja e pjesëve të tregut është bërë nga përpunimi i të dhënave të siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

⁵ CR5 për gjithë vitin 2008 është 82.7%, kurse HII për vitin 2008 është 1725

⁶ HHI (Indeksi i Herfindahl-Hirschmann) është matës specifik i përqendrimit të tregut. Ky indeks mbledh katrorët e pjesëve individuale të tregut të të gjithë konkurrentëve për të parë nivelin e përqendrimit të tregut. Ne rastet kur HHI < 1000 tregu është jo i përqendruar, 1000 < HHI < 1800- mesatarisht i përqendruar, HHI > 1800 - shumë i përqendruar. Indeksi HHI në vitin 2005 është 3142.7; në vitin 2006 HHI është 3331.4 ; në vitin 2007 HHI është 1841.9 dhe për 8-mujorin e vitit 2008 HII është 1469.4

⁷ (Concentration rate 3) Shuma e pjesëve të tregut që zene tre ndërmarrjet më të mëdha në tregut. CR3 në tregun e shitjes së miellit është XXX% për vitin 2005; XXX% për vitin 2006; XXX% për vitin 2007 dhe XXX% për 8-mujorin e vitit 2008.

ku tre ndërmarrjet “Atlas” Sha, “Bloja” Sha dhe “Miell Tirana” Sha janë ndërmarrjet kryesore në treg. Në vitin 2008 ndërmarrjet “Atlas” Sha dhe “Bloja” Sha zotërojnë pjesë të barabarta tregu me nga 25% secila.

15. Tre ndërmarrjet kryesore në tregun e shitjes së Miellit (CR3) janë “Atlas” Sha, “Bloja” Sha, dhe “Shoqëria Anonime Mielli” Sha, të cilat zënë XX% për vitin 2005, XX% për vitin 2006, XX% për vitin 2007 dhe për periudhën janar-gusht 2008 zënë në XX% të tregut. Ndërmarrjet “Bloja” Sha dhe “Atlas” Sha ruajnë klasifikimin sipas pjesëve të tregut gjatë viteve 2006-2008

16. Gjate viteve 2005-2007 tregu i prodhimit të miellit ka qenë shumë i përqendruar. Indeksi HHI në vitin 2005 ka qenë XXX duke u ulur në XXX gjatë vitit 2006 dhe në XXX gjatë vitit 2007. Niveli i përqendrimit është ulur nga viti në vit duke arritur në një ndarje proporcionale në 8 mujorin e vitit 2008 midis “Bloja” Sha dhe “Atlas” Sha, por përsëri shkalla e përqendrimit me XXXX në këtë vit është përsëri e lartë.

17. Nga analiza e tregut të shitjes së miellit për bukë, rezultoi se ky treg paraqet karakteristikat e një tregu oligopolistik më tre ndërmarrje me pjesë tregu të konsoliduara gjatë viteve 2005-2008. Ndërmarrjet me fuqi tregu janë “Atlas” Sha, “Bloja” Sha dhe “Shoqëria Anonime Mielli” Sha.

Barrierat e hyrjes

18. Ndërmarrjet me fuqi më të mëdha të importit të gruri janë njëkohësisht edhe prodhuesit më të mëdhenj të miellit. Ky integrimi vertikal i ndërmarrjeve është një barrierë e fuqishme për hyrje të reja në treg, sidomos në tregun e prodhimit të miellit.

19. Pozita e konsoliduar e ndërmarrjeve në treg, qëndrueshmëria e pjesëve të tregut në vite, eksperiencia apo reputacioni, teknologji dhe kapacitetet larta përpunuese krijojnë vështirësi për një hyrës të ri. Për këtë arsye, një hyrje e re në këtë treg kërkon një investim shumë të madh dhe të jetë pjesë e integritit vertikal si ndërmarrjet e tjera. (të sigurojë vetë lëndën e parë nga importi) për të përballuar konkurrencën në treg.

Fuqia kundërvepruese e blerësve

20. “Fuqia kundërvepruese” e klientëve është e vogël si në tregun e shitjes së grurit ashtu dhe në tregun e prodhimit të miellit. Blerësit e grurit (blojet e vogla) janë ndërmarrje të detyruara të sigurojnë lëndën e parë për të mbajtur në punë linjat e prodhimit, të punësuarit e tyre dhe klientët e tyre të miellit. Kryesisht këto bloje janë ndërmarrje që operojnë jashtë Tiranës dhe në tregun e tyre të shitjes së miellit kanë konkurrentë të fortë ndërmarrjet e mëdha të miellit të Tiranës (të cilët operojnë me shitës shumice ose distributore). Fuqia e klientëve të miellit për të kundërvepruar është edhe më e dobët se e klientëve të grurit, pasi këta (furrtarët) janë biznese të vogla, shumë prej të cilëve të palicencuar dhe për më tepër me detyrime debitore ndaj ndërmarrjeve të miellit dhe janë të detyruara të pranojnë çmime të caktuara prej tyre.

Analiza e Integrimit Vertikal në Tregun e Grurit dhe tregun e Prodhimit të Miellit

21. Nga analiza e strukturës së tregut të importit të grurit u konstatua se “ndërmarrjet “BLOJA” Sha, “ATLAS” Sha, “MIELL” Sha , “VLLAZNIMI B” Shpk, “ITALIA AGRIFOOD” Shpk, “ALB –MINES INVESTMENT” Shpk, veprojnë në tregun e importit të grurit dhe në tregun e prodhimit dhe shitjes së miellit. Pra këto ndërmarrjet janë të integruara vertikalisht në të dy tregjet

22. Në një treg konkurrues, integrimi vertikal çon në uljen e kostove dhe rritjen e eficientëve në produktin përfundimtar (tregu i miellit), e cila duhet të çojë dhe në uljen e çmimeve. Por nga analiza e çmimeve të shitjes së miellit, u konstatua se ndërmarrjet e integruara tregtojnë më çmim më të larta se ndërmarrjet e paintegruara, pra ky integrim nuk ka sjellë eficientë në treg, por vetëm ka krijuar barriera për hyrje të reja në tregjet përkatëse dhe ka rritur presionin mbi ndërmarrjet e paintegruara të shitjes së miellit për të punuar në marzhe të ulëta fitimi

IV. ANALIZA E KONKURENCËS

23. Tregu i importit të grurit është një treg oligopolistik, mesatarisht i përqendruar, ku ndërmarrjet pjesëmarrëse kanë pozita të konsoliduar dhe fuqi ekonomike të konsiderueshme. Ka ndërmarrje që kanë fuqi të madhe të tregut të shitjes së grurit dhe duke qenë se zotërojnë linja të përpunimit të miellit, ato janë dhe ndërmarrjet kryesore në tregun e shitjes së miellit.

24. Tregu i shitjes së miellit paraqet karakteristikat e një tregu oligopolistik me një shkallë të lartë përqendrimi, me ndërmarrje të konsoliduar dhe zotërues të teknologjive të përparuara dhe ekonomike të fuqishme, të cilat e ushtrojnë aktivitetin e tyre brenda një tregu lokal.

25. Nga hetimi, ka rezultuar se ekziston një marrëveshje ndërmarrjet Atlas sha dhe Bloja sha, fakt i cili ka sjelle kufizim të konkurrencës në këto treg. Duke vlerësuar këtë situatë, pra sjelljen jo konkurruese të këtyre ndërmarrjeve në treg, marrëveshja⁸ midis tyre është konsideruar e ndaluar e parashikuar në nenin 4 të ligjit, pika 1, për këto arsye Komisioni i Konkurrencës vendosi me Vendimin Nr.113 datë 19.05.2009, ndalimin e kësaj marrëveshje. Në vijimësi Komisionin i Konkurrencës është shprehur për efektet e kësaj marrëveshje me Vendimin nr. 125.

26. Gjatë periudhës hetimore është vërejtur se :

1-Çmimet e faturave nuk shprehin çmimet reale të aplikuara gjatë realizimit të trasaksioneve.

2- Nuk mund të ketë shkaqe të arsyeshme që një ndërmarrje me fuqi të ndjeshme në treg të ketë tregues financiar negativ.

⁸ Gjatë hetimit rezultoi se marrëveshje për blerje të përbashkëta, kanë patur dhe ndërmarrjet “Vllaznimi B” Shpk me “ITALIA AGRIFOOD” Shpk, por nuk u vërtetuan kufizime të konkurrencës në treg. Gjithashtu, ndërmarrjet “IAM” Shpk dhe “GLAN” Shpk, megjithëse kanë lidhje familjare midis ortakëve, tregtojnë me çmime të ndryshme dhe nuk bëjnë blerje nga i njëjti burim furnizimi.

3-Çmimet e references të aplikuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (në ato raste që janë aplikuar), sjellin deformimin e çmimeve reale të transaksioneve të ndodhura.

Këto fenomene ndikojnë në analizën e konkurrencës të realizuar nga Autoriteti i Konkurrencës mbi sjelljen ndërmarrjeve në treg.

Komisioni i Konkurrencës në vlerësimin e sjelljes së ndërmarrjeve në treg dhe të faktorëve që ndikojnë në këtë sjellje, është drejtuar dhe nga interesi publik në tërësi dhe ai i konsumatoreve në veçanti.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja “d”, “f” si dhe nenin 70 pika 2 e Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”

V E N D O S I:

1. Mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit, të nisur me Vendimet Nr. 88 datë 02.10.2008 dhe Nr. 101 datë 05.02.2009 të Komisionit të Konkurrencës;
2. T'i rekomandoje Ministrisë së Financave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të rishikojë praktikën e çmimeve të referencës në tregun e importit të grurit, për efektet e mundshme që mund të sjellin në kufizimin e konkurrencës në treg.
3. T'i rekomandojë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve që gjatë praktikave të rivlerësimeve të mbajë parasysh efektet që mund të sjellin në treg për konkurrencën.
4. T'i rekomandojë Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar që të sigurojë se pasqyrat financiare pasqyrojnë saktë dhe drejt gjëndjen pasurore dhe situatën financiare të ndërmarrjeve Atlas Sha dhe Bloja Sha, si dy ndërmarrje me fuqi të madhe në treg.
5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm t'i komunikojë këtë vendim organeve përkatëse.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

(_____)
Anëtar

Rezana KONOMI

(_____)
Anëtar

Koço BROKA

(_____)
Anëtar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R

